



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/04/25
Datë: 23.04.2025

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.09.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESË

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: Shpejtim Gacaferi – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: Mbledhja e katert (04) - e rregullt 2025 të Legjislacionit V të Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 30.04.2025, ora 10⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i raportit financiar të Komunës së Junikut për periudhën e pare janar-mars 2025;
4. Informatë lidhur me gjendjen e arsimit në komunën e Junikut;
5. Nxjerrja e vendimit për fillimin e plotësim-ndryshimeve të projekt Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa per vitin 2026;
6. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit;
7. Të ndryshme.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/04/25
Datë: 23.04.2025

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.09.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESË

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: **Shpejtim Gacaferi** – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: Mbledhja e katert (04) - e rregullt 2025 të Legjislacionit V të Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 30.04.2025, ora 10⁰⁰.

Rendi i ditës:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i raportit financiar të Komunës së Junikut për periudhën e pare janar-mars 2025;
4. Informatë lidhur me gjendjen e arsimit në komunën e Junikut;
5. Nxjerrja e vendimit për fillimin e plotësim-ndryshimeve të projekt Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa per vitin 2026;
6. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit;
7. Të ndryshme.



REPUBLIC OF KOSOVO/REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

Doc. No. Pril: 2-155/9713
No. i dor: 3
Data: 15/04/2025



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

DATE/A:	15.04.2025
NR/BR/NO:	7/17
PËR/ZA/TO:	z. Shpejtim Gacaferi, Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
Permes:	z. Ruzhdi Shehu, Kryetar i Komunës Junik
NGA/OD/FROM:	Xhavit Velijaj- Drejtues i Drejtorisë për Arsime, Kulturë, Rinë dhe Sport (DAKRS)
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informata lidhur me gjendjen e arsimit në komunën e Junikut

I nderuar,

Institucionet Edukativo-Arsimore (IEA) në komunën e Junikut janë duke e zhvilluar procesin mësimor sipas kalendarit të vitit shkollor 2024/2025 dhe planprogrameve mësimore.

Në komunën e Junikut janë katër nivele të arsimit parauniversitar:

- Niveli parashkollor;
- Niveli Fillor
- I mesëm i ulët dhe
- Shkolla e mesme e lartë- Gjimnazi,
- Niveli parashkollor për grup moshat 0-5 vjeç, ky nivel është duke vijuar në aneksin e objektit të Shkollës fillore e mesme e ulët (SHFMU), ndërsa projekti i adaptuar i objektit për Çerdhe-Kopsht të kësaj grupmoshe është në fazën përfundimtare të finalizimit me të gjithë infrastrukturën përcjellëse, ky projekt është zhvilluar falë investimeve nga Komuna e Junikut dhe MASHTI-të. DAKRS ka filluar procedurat e themelimit të Institucionit Parashkollor. Ndërsa, grup moshë 5-6 vjeç funksionon në kuadër të SHFMU, vijueshmëria është e obligueshme për këtë grup moshë.
- Mësimi në nivelin fillor dhe i mesëm i ulët është duke vazhduar normalisht në gjysëmvetorin e dytë të këtij viti shkollor. Pas përfundimit të gjysmë vjetorit të parë janë analizuar rezultatet e suksesit për nivelin fillor ku kemi notën mesatare prej 4.2, ndërsa, për nivelin e mesëm të ulët kemi notën mesatare prej 2.95.

Në këtë nivel migrimi i nxënësve është në trend të vazhdueshëm, gjatë këtij viti shkollor kemi 5 nxënës që kanë migruar jashtë vendi.

- Gjithashtu në gjimnaz mësimi është duke vazhduar normalisht në gjysmë vjetorin e dytë. Pas përfundimit të gjysmë vjetorit të parë janë analizuar rezultatet e suksesit për nivelin kemi notën mesatare prej 3.25.

Për plotësimin e nevojave për mjetele e punës (didaktike) në mirëmbajtje, kabinete dhe sallën e edukatës fizike, kemi bërë kërkesë në MASHTI, që të na bëjë furnizimin sipas kontratës që kanë, presim që gjatë këtij viti furnizimi të bëhet sipas kërkesave të IFA. Furnizimi me materiale higjienikë janë bërë sipas kërkesave të IFA.

Në tabelën e më poshtme janë të dhënat statistikore për numrin e fëmijëve, nxënësve, dhe personelin që punon në IFA të komunës së Junikut.

Nr.	Niveli shkollor	Fëmijë	Nxënës me nevojat e veçanta	Nxënës	Mësimdhënës	Faktor	Mësimdhënës në arsimin special	Asistent për fëmijë me nevojat e veçanta	Pedagog	Këshilltarë në karrierë	Sekretar	Drejtor	Punëtor teknik
1.	Parashkollor Qerdhe-Kopsht grupmoshat 3-5 vjeç	25				2							
2.	Parafillor grupmoshat 5-6 vjeç dhe Arsimi fillor	35	7	199	14	2	1	3	1	1	1	1	5
3.	Arsimi i mesëm i ulët			200	22								
4.	Arsimi i mesëm i lartë			160	16							1	2
	Totali	60	7	559	52	4	1	3	1	1	1	2	6

Gjatë këtij viti shkollor janë zhvilluar dhe janë duke u zhvilluar disa projekte infrastrukturore siç janë:

- Projekti "Rregullimi i infrastrukturës së oborrin SHFMU Edmond Llojha", presim që gjatë këtij viti të finalizohet faza e dytë të projektit.

- Projekti për hapësirat e SHFMU "Edmond Hoxha", ky projekt pritet të finalizohet gjatë muajve në vazhdim, ku përfshihet fusha e sportit, parqet, parkingu i shkollës, ndalja për autobus për transportin e nxënësve, hapësirat e jashtme të Çerdhes-Kopsht me parking etj.
- Në objektet e IEA, gjatë këtij viti është finalizuar njetëzimi i infrastrukturës digjitale.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 02-03/25
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATË/A	28.03.2025
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së tretë (03) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 28.03.2025, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti, nenkryetarin e Komunës së Junikut z.Besart Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit me pas konstatoi se mbledhje marin pjese te 15 anëtarët e kuvendit. Në mbledhje nga drejtoret prezent ishin: znj.Leonora Shehu AD,znj.Vjollca Qestaj-DBF,z.Jetmir Jasiqi-DEZH, z.Zenun Shala DUKM, z.Fatos Shala-DSHMS, z.Demokrat Ganiqaj-DSHPMSI.

Anëtarët prezent

- | | |
|---------------------------------------|--------------------------------------|
| 1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK | 10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK |
| 2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK | 11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK |
| 3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK | 12. Festina Maloku - Anëtare, AAK |
| 4. Mursel Salihaj-Anëtar,LDK | 13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV |
| 5. Ermelinda Lllolluni - Anëtare, LDK | 14. Eliza Pepshi-Anëtare,LVV |
| 6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK | 15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV |
| 7. Leonard Lllolluni - Anëtar, AAK | |
| 8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK | |
| 9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK | |

Rendi i ditës i paraparë

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 ne vitin 2025,
4. Njoftim mbi shfrytëzimin e pronave komunale,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës të Planit Lokal për barazi gjinore 2025-2027 dhe Plani i Veprimit,
6. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit, dhe
7. Të ndryshme.

Rendi i dites u miratua me 12 vota per, 0 voa kunder dhe 0 vota abstenim

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje,

Ne kete mbledhje mungojne, z.Zenel Maloku-AAK, znj.lirjeta Shehu-LDK dhe z.Alfred Gaxherri-LDK.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese nuk ka e qes ne votim procesverbalin nga mbledhja e kaluara, kush eshte per, per 12 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se procesverbali i mbledhjes se kaluar u miratua.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 ne vitin 2025,

Para se ta mere fjalen znj.Vjollca Qestaj per arsyetimin e bartjes se te hyrave vetanake ne salle erdhi antari i kuvendit z.Zebel Maloku me pas.

Sqarimin dhe arsyetimin e bartjeve te te hyrave vetanake nga viti 2024 ne vitin 2025 e beri znj.Vjollca Qestaj-drejtoreshe ne DBF e cilla fillimisht i pershendeti te gjithe me pas e sqaroi dhe e arsyetoi bartjen e te hyrave vetanake nag viti 2024 ne vitn 2025, para antarve te kuvendit.

z.Leonard Llolluni, pershendetje per te3 gjithe, une deshta nje sqarin per shume prej 84803€, qe eshte ne kategorin e shpenzimeve kapitale, bashke finacimi i projekteve dhe kisha dashte te kemi me shume informacione se per cilat projekte behet fjale, edhe te ndertimi i rrethojes dhe rekusturimi i oborrit ne stacioni e autobusave, ne kemi mare infomacion po nga ky kuvend se per kete projet kemi mare nje donacion nga ministria e zhvillimt rajonal, po ashtu ky projekt

regullimi i oborrit ne shkollen fillore “Edmond Hoxha” ne e dime se ky projek ka perfunduar moti, si do qofte te bashkefinacimi i projekte kisha dashtur te di se per cilat projekte behet fjale.

znj.Vjollca Qestaj, per keto projekte kemi folur di sa here ne kete kuvend po mundeni edhe ne web-faqen e komunes te merni si infomacion per keto projekte por si do qofte po jau rikujtoj edhe nje here se behet fjale per keto projekte, rikonstruimi dhe zgjerimi i rruges Junik-Rastovice ne vler prej 610886€, projekti tjete eshte asfaltimi i rrugeve ne lagjen Berish, Gacafer, Gaxherr dhe Qender ne vler prej 20003€, projekt tjeter eshte rikonstruimi i kanalizimit ne Lagjen Agim Ramadani , Qender, Krasniq, Berishe, Bajraktar, Gacafer ne vlere prej 10000€, po ashtu komuna eshte ne bashkefinacim ne projekti e perbashket me Demos dhe MAPL ne vlere prej 44500€ keto jane projekte.

z.Lulzim Gacaferi, pershendetje per te gjithë, e di se ju nuke ekeni bere projektin e stacionit te autobusave ne Junik, dhe une keto jame takuar me drejtusit e kompanivet te autobusave qe operojne ne Junim dhe ata jane ankuar se hyrja dhe dalja ne kete stacione nuk eshte ne baza te nores qe kerkohet, po ashtu po thuani se keni ndare nje shume te kosiderume te mjeteve per rikonstruimin e oborrit ne kete stacion, tani pyetja shtrohet pse objekti i stacionave ka dy vite qe eshte ndertuar dhe akoma eshte i mbyllur.

z.jetmir Jasiqi, pershendetje per te gjithë, objekti percjelles ne stacioni e autobusave nuk eshte funksional sepse ende nuk ka perfunduar, ndersa sa i perkete hyrjeve dhe daljeve ne e kemi zgjonuar hyrjen dhe daljen dhe tash me nuk ka ndonje problem per ket qeshtje.

z.Leonard Llojluni, meqe e kemi drejtorin eurbanizimit ketu prezent, kemi nje shume prej 10390€ kategoria ekonomike mallra dhe sherbime nese mundet me na sqary se per çka behet fjale.

z.Zenun Shala, pershendetje per te gjithë, kjo shume eshte e dedikuar per operatorin qe eshte duke na percjellur ne projekte.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese tjeter nuk ka e qes ne votim bartjen e mjeteve e vetanake per nga viti 2024 ne vitin 2025 kush eshte per, per 11 vota, kunder 2vota dhe 0 vota abstenim, konstatoi se bartja e mjeteve vetanake nga viti 2024 ne vitn 2025 u miratua.

4. Njoftim mbi shfrytëzimin e pronave komunale,

Sqarimin dhe arsyestimin e shfrytëzimin te pronave komunale e beri z.Zenun Shala drejtor – DUKM i cili edhe nje here i përshëndeti te gjithë te pranishmit dhe me pas e sqaroi dhe e arsyetoje para antareve te kuvendin njoftimin mbi shfrytëzimin e pronave Komunale.

Kerkese nuk pati

5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës të Planit Lokal për barazi gjinore 2025-2027 dhe Plani i Veprimit,

Sqarimin dhe arsyetimin e Planit Lokal per bazi gjinore e beri znj.Leonora Shehu drejtoreshë – AD, e cilla fillimisht i përshëndeti te gjithë me pas e sqaroi dhe e arsyetoi para anetarev te kuvendit planin lokal per barazi gjinore per periudhën 2025-2027 si dhe panin e veprimit.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese nuk ka e qes ne votim Planin Lokal per barazin gjinore 2025-2027 si dhe planin e veprimit kush eshte per, per 13 vota kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se plani i veprimit per barazi gjinore u miratua.

6. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit

z.Lulzim Gacaferi, pyetje per drejtorine urbanizmit, a e keni hartuar projektin per rrugen ne lagjen Gacafer dhe sa keni punuar ne kete drejtim?

z.Zenun Shala, operatori qe e kemi kontratuar per projekte shume shpejt pritet te del ne teren qe ti beje matjet dhe ne rrugen e lagjes Gacafer dhe projekti do te jete shume shpejt i gatshem.

z.Zenel Maloku, une kam pyetje per drejtoreshen e Administartes, a ka komuna komision diciplinor kur nje puntor i kones ban shkelje dhe nese ka kush jane anetaret e keti komisioni.

znj.Leonora Shehu, per secilin raste qe ka qeshtje te ngritur kryetari i Komunes me nje vendim ngrit nje komision diciplinor, per momentin nuke kemi komision diciplinor te ngritur.

z.Lulzim Gacaferi, pyetje per Kryetarin e Komunes por meqe nuk eshte kryetari prezent pergjigjen mund ta jepe edhe nenkryetari, pyetaj ka te beje me ujin e pijes ne lagjen Agim Ramadani, pse nuke e keni patur te arsyshem qe ne mjete qe bartem nga viti 2024 ne vitin 2025 ti ndani nje shume te tyre bashkfinacim me Hidrodrine qe edhe banoret e lagjes Agim Ramadani ta kene ujin e pijes si ter pjesa tjeter e konubes se Junikut.

z.Besart Tofaj, pershendetje per te gjithë, ashtu siq edhe u cek ne pikne e rendit te dites qe u diskutuar me heret nga drejtoresha e Buxhetit te gjitha mjete qe u bartet nga viti 2024 ne vitin 2025 jane obligime nag viti i kaluar me marrveshe qe vetem jane te nenshkruar nga viti i kaluar keshtu qe ne shume qe eshte planifikuar te bashkefinacimi nuk kemi pasur mundes, te futim projekt te ri, ne si komune kemi biseduar me kompanin hidrodrin, por der tani nuk kemi hasur ne mirekuptim nga ta, kemi acarim te mardhenjeve me ta pikerisht per kete qeshtje andaj mbesim me shprese qe ministria e linjes te ndermar diqka ne te ardhmen pasi qe kjo qeshte eshte folur edhe ne kuvendine Republikes se Kosoves.

z.Leonard Lolluni, pyetja ka te beje me mbeturinat inerte, inspektora e komunes a dalin te bejne vzhgime per keto deponi pasi qe ka deponi te reja e nje nder to eshte tek lumi Trava afer varrezave, per deri sa kta inspektor dalin per ta inspektuar nje ndertim te nje varri pse nuk dalin ta inspektojne kete deponi sepse aty jane duke hudhur mbeturina me te madhen.

z.Besart Tofaj, ne do ti dergojme inspektorat qe ti inspektojne keto deponi, dhe nese ka dike qe hudhe mbetorina ata do te gjobiten, por edhe do te marin masa qe permes kamerave te indentifikojne kta persona dhe ti gjobitni, ndersa sa I perkete inspektimi te varrezat, edhe

inspektorat por edhe policia reagojne ne baze te nje njoftimi ose ne baze te nje lajmrime jane te obliguar te reagojne.

z.Dervish Bajraktari, pershendetje per te gjithë, pyetjet jane, kur fillon projekti per qenderne ne Junik, kur fillon projekt per ujin e pijes ne lagjen Agim Ramadani, kur fillon rindertimi I shtratit te lumit Erenik, kur do te happen rruget fushore qe jane kerkesa qe dalin nga ky kuvend qe dy vite me radhe, keto jane premtime qe ju I keni dhene gjate fushates zgjedhore, po ashtu u permenden deponit ilegale nje e keni mu ne parkun e varrezave te qytetit, po ashtu nje te Kroni I madhe, dhe po ashtu keni postuar ne facebook se projekti vendosja e kamerave ka perfunduar dhe tani kamerat jane funksionale a kur po duhet qe ta denoni dike po thuani se kamerat nuk funksionojn ketu dikush po mashtron.

z.Besart Tofaj, sa I perkete kamerave jane funksionale dhe ato menaxhohen nga Policia e Kosoves, sa I perkete lumit Erenik, e ka then edhe drejtori me heret se kane kerkuar leje per nderhyrje ne pastrimin e lumit por kjo leje ende nuk na eshte dhene nga ministrija e mjedisit departamenti I ujrave, ndersa sa I perkete ndertimit te qendres se Junikut je e dini se qe nga viti I kaluar kemi filluar me projektin dhe kete vite kemi nje qeshtje se mjete e parapara per kete projek jane tehequr nga thesari nga permbaruesi.

7. Te ndryshme.

z.Zenel Maloku, u permend ne kete mbledhje uji I pijes per lagjen Agim Ramadani, dhe une kisha kerkuar qe kjo qeshtje te mos permendet me sepse eshte bere si kenga e Mujes, per kete uje qe lagjeja Agim Ramadani ka per momenti ka zyrtar te komunes qe thojne se eshte I pishem, por keta uje dikush nga banoret as teshat nuk I lane me ta a ka qe edhe e pine, qeshtja tjeter qe u permend inspektimi I vorreve, a keni inspektor qe I dergoni te inspektoi te gjitha vorret, po ine kisha kerkuar qe te keni kujdes me keto gjana sepse nuk jeni pergjithmon ne komune kjo vlene per te gjithë neve, komuna eshte e qytetarve te Junikut dhe te gjithë jan ete barabarte para saje dhe do ishte mire qe per deri sa e kryeni ate sherbim ta kryeni me nder, keni thene se keni nxene vendin e pare per performanc, sat te zeza keni ber ju mun ta keni nxen vendin e pare per te zezat qe I keni ber, dhe ato se I keni bere neper komuna tjera te Kosoves nuk kan ndodhur, kjo eshte performanca e juaj dhe puna qe keni bere.

z.Lulzim Gacaferi, sa I perkete ujit te pijes per Lagjen Agim Ramadani, ne ne 2021 kemi premtuar se kjo do te kryhet dhe pergjisia I bije keti pushteti aktual qe nuk e ka ber deri tani, pergjesia bije mbi kryetarin dhe bartsit te ti dhe eshte per te ardhur keq se pse nuk ka ndodhe qe uji I pijes te shkoj edhe ne kete lagje qe jane banore te kesaj komune, qeshtja tjete ka te bejem me nje hapje te hapsires qe ka ndodhur ne lagjen Agim Ramadani afer shtepsi se drejtorit te sherbimeve publike eshte nderuar nje autopark, une kame bere nje kerkese te kryetari komunes qe te na I sjelle dy shtylla te ndriqimit publik edhe tek lagjeja Oda Residenc, ku parashihet te

ndertohet nje lagje dhe eshte nje investim mbi 10 miljonsh, dhe nga kryetari na eshte then qe duhet te keni leje ndertimi dhe normalisht se ate leje edhe kemi dhe andaj si eshte e mundur qe prane shqiptarise se drejtorit te beni kete hapje a neve nuk jeni ne gjendje te na bini dy shqylla te ndriqimit publik, po ashtu lagjes Juniku I ri qe pronar eshte z.Jasiriq aty e keni instaluar ndriqimin publik a per lagjen Oda Residenc nuk keni ber, andaj mendoj se kjo eshte selektive.

z.Zenun Shala, projekti ka qene I parapare deri aty ku eshte I ndertuar tani, kete e ka konstatuar edhe menaxheri I komunes por edhe menaxheri I kontratese nga ana e ministris, por te ta vazhduar deri aty ku ju kerkoni ne do te shiqojme mundesit e tona buxhetore dhe besoj se do ti sjellim edhe deri aty ndriqimin publik.

z.Zenel Maloku, ne banoret e lagjes Agim Ramadani kemi bere kerkese ketu ne kuvend qe hapsirat e kyqjes ne rrugen kryesore qe shpije per Junik te jete shikushmeria e dukeshm nga ana e djathte dhe aty ka nje penges nga nje rrethoje qe ekziston, dhe per kete kemi njoftuar edhe komune, dhe deri tani komuna nuk ka ndermar asgje per kete qeshtje, une prap beje kerkese qe ne ate pjese te kete hapsir te duhur qe ne si qytetar te asaj lagjeje te kemi mundsi te kyqemi ne rrugen kryesore, sepse keshtu siq eshte mund te kete pasoja sese nuk ka hapsir te duhur te shikushmeris se rruges.

z.Demokrat Ganiqaj, pershendetje per te gjitha, per kete kerkese qe foli z.Maloku per kete arsyje eshte larguar ata dhe qe po thuani ju z.Gacaferi dhe me pas kam kerkuar nga kompania qe ta shroje me zhavor dhe ajo pjese nuk eshte para shtepi time por para shtepis se vellaut, dhe ate pjese mun ta shfrytezo çdo kush, ndersa sa I perkete qeshtjes se e greti z.Maloku per rrethojen, ne si drejtori ja kemi derguar tri here njoftimin banorit te asja shtepije qe ta largoje rrethojen sepse po pamundson shikushmerin e rruges dhe po rrezikon qasjen ne rrugen kryesore, dhe tani jemi ne ate faze qe ne forme repersive ta largojme ate rrethoje.

z.Zenel Maloku, une vetem po dua ta theksoj se rrafshimi I pjese se majt nuk eshte bere per dukshmerin qe po pretendon drejtori.

z.Xhavit Veliqaj, pershendetje per te gjitha, u fol ketu per shume gjera, dhe nuk eshte e veret se gjithçka eshte zi si po pretendohet ketu nga z.Maloku, ne prej se kemi ardhur, kan qen premtimet kan qen sfidat por sfida me e madhe ka qen trashegemia qe kemi gjetur ketu, problemet qe jane gjetur dhe qe do te shkojne shume vite tjetra per tu sanuar, per kunder kesaj duhet te jemi te sinqerte se punet qe jane duke u bere dhe proceset qe po ndodhin do te preceptohen nga qytetrate dhe sfide tjere qe po ballafaqohemi eshte edhe kontrata kolektive e cila po ashtu eshte e trasheguar dhe nga kjo jane duke nau terhequr mjeten çdo kund ku po mundeni dhe duhet te jemi rehal dhe ta tregojme te verteten, une pajtohem qe ka hapsir per tu permisuar dhe secil ka hapsir dhe mundsi per permisime dhe jo te gjuajm etiketa se ketu asgje nuk eshte bere.

z.Zenel Maloku, me gjitha respektin qe kam per ty dhe t gjitha drejtorat tjere, tregomse çka thash se nuk eshte e vertete, kjo qe e thash eshte shume e pakte nga ajo se çka kame me shume per te then, une asgje spo them çka nuk eshte, por ti drejtor do ishte mire qe te meresh me ate pune qe ti

je I ngarkuar, bilem do ishte mire qe te tregosh per nje problem qe na ndodhur keto dite ne shkolle, sepse ne kemi informata se ka ndodhur nje problem por per afte te mire eshte snauar, por po te hyje anej me treguar se cka ka ndodhur ne mandatin tuaj ti do ta kaoesh kryet me duar, sepse per keto qe po them kan shkruar edhe gazetatat.

z.Besart Tofaj, une deshta te nderlidhem me pyetjet me me hershme, sa I perkete cilsimit te ujit te pijes ne lagjen Agim Ramadanin ne kemi raporte nga instituti qe meret me cilsimin e ujit te pijes, edhe per inspektimin te varreza, po e theksoj prap se edhe inspektorat edhe komune edhe zjarrfiksat por edhe policija reagojne ne baze te nje informacioni.

z.Leonard Lolluni, meqe e mori fjalen drejtori z.Velijaj, qe per mendimi tim eshte njeri nder drejtorat qe me se pakti ka punuar ne kete mandat, dhe nuk ka te drejt te fole sepse e mori fjalen pa e kerkuar nga ai asnje sqarim, sepse askush nuk ja permendi emrin dhe e mure fjalen per te bere politik, dhe meqe e mor fjalen per te bere politik dhe ne po bejem politik, ku thot se nuk po jane mundsit, prap po thirret ne ate se pushteti I kaluar, a ne pushtet kur keni ardhur ju si LDK e keni patur moton Juniku per te gjitha a ne fakte keni punuar vetem per LDK, drejtori dhe kryetari I kane ditur mundsit edhe para se te vine ne pushte, dhe nuk eshte e moralshme te thuhet tash nuk po kemi mundsit, nuk eshte qe qeveria qendrore qe nuk I ka perkar por siq duket komuna e junikut ja ka huqe me ka krejt, po ashtu kontrata kolektive nuk ka te beje me pushtetin e kaluar ju e dini kete dhe nuk ka te beje fare me komuna, po ashtu keni then ate e kta e ke then ti pikerisht kryesues se ju e keni vendin ne burg, kush shkoj ne burg askush.

z.Xhavit Velijaj, u tha se nuk kam punura, dhe une po ju them se ju nuk jeni ai qe me vlersoni per pune time, duhet te bazohi ne argumente ne fakte, ne kem bere me mira euro investime ne arsim jo te flasim me inate.

z.Besart Tofaj, ne I kemi bere ato premtime dhe do te mundohemi te ralizojme, dhe e kemi dite edhe mundesit buxhetore por ate qe nuk e kemi ditur eshte se nuk ikemi ditur sfidat, sfidat qe jane kryer punimet fatuarat kane ardhur e lumi Erenik ka shkuar ne Gjakove, e permbaruesi na I mere parat ne vitin 2025, po ashtu nuk e kemi ditur se ujin qe e ka mare Gjakova, ka me na paditur me 170000€ KRU Gjakova, po ashtu nuk e kemi ditur se kontrata kolektive do te na mere me permbaruesin mjete qe jane parapara per projektet e viti te kaluar e qe ne kete vite do te perfundoni, sikut te mos na I terehekni ato mjete finaciare, por edhe per kunder kesaj ne duhet te jemi falemenderues ndaje qeveris qendrore se na ka perka per projekt te caktuar.

z.Lulzim Gacaferi, po me vjen mire qe nenkryetari po e permend ndimen e qeveris qendrore, sepse sikur te mos ishte qeveria Kurti te jau sjelle 2000000€ per segmentin e rruges Junik-Rastavi, 120000€ per stacion te autobusave, 120000€ per qerdhen e femijeve, 650000€ per unazen e Komunes se Junikut, mbi 200000€ per kanalizime, 100000€ per rrugen Jasiq-Gjocaj, 120000€ per uren ne Jasiq e shume e shume tjera duhet te jeni mirenjos, sepse sikut te mos ishin keto investime nga qeveria Kurti ju nuk do te kishi mundur ta beni nje pune te tille, tash kam edhe nje qeshtje tjeter, une ishat te shtepija e z.Tafë Hoxha, ku eshte duke u ndertuar rruga dhe

muret mbrojtës, në mbledhjen e fundit keni then se nuk është e parapar të ndertohet trotuar në atë pjesë, në kemi folur me pronarët e atyre pronave dhe kta pronar na kanë premtuar se do t'i lejon që aty të ndertohet rruga me gjithë trotuar, kete e ka pranuar edhe pronari z.Elez Hoxha, dhe une po duat të di se kur do të fillojnë punë në atë pjesë dhe a keni biseduar edhe ju me ta si komune, meqë e kam fjalën desha të di edhe nga drejtori i shërbimeve se kur do të riparoni kamionat për zjarrefikje.

z.Dervish Bajraktari, në në vitin e kaluar I kemi pyetur drejtoreshën e financave se a ka ma borje të kaluar se njëmend u teprua jo borjet jo borjet, dhe pergjigjja ka qen se nuk ka borje dhe tash do të fillojnë të investojnë në projekte, dhe tash une ju kuptoj se jeni nën ethe sepse nuk do t'i keni me kto pozita që I keni jo nga në por nga qytetaret, dhe tash prap po arsyetoheni se po punohet se nuk po keni para, tash po dalin faturat e lumit erënik që ju nuk I paski ditur deri sot, po ashtu po dua të them se qasja e nënkryetarit sot po me gezon sepse në keto tre vite e gjysmë nuk ka qenë aktiv aspak, paske filluar të aktivizohesh dhe në spo dime se ka je a me ata a me kta.

z.Demokrat Ganijaj, në e kemi një kontratë për servisimin e autojeteve dhe sa here kanë pasur nevojë ato automjete janë servisuar, po ashtu njësitë I zjarrfikësve është I paisur me të gjitha mjete për punë sepse kemi marrë donacion nga KFOR-I Italian.

z.Zenun Shala, sa I perketë rrugës tek Hoxhajt tre pronar të pronave kanë leshuar hapsir, z.Elez Hoxha nuk ka leshuar hapsir, ka leshuar aq sa në I kemi kërkuar në fillim, kta tre pronarët kanë leshuar edhe nga 50cm me shumë ndërsa z.Elez Hoxha ka qen për tre ditë tek kryetar dhe ka then se nuk mundet të leshoj me shumë sepse ka shumë pak hapsir, dhe në kemi ardhur në përfundit që ta ndërtojmë rrugën aq sa ka hapsir.

z.Shpejtim Gacaferi, në mungesë të korumit e mbylлим mbledhjen e Marsit 2025

Procesmbajtësi:
z. Esat Hoxha

Kryesuesi i Kuvendit:
z. Shpejtim Gacaferi



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF
KOSOVO



KOMUNA E JUNIKUT
OPSTINA JUNIK/ MUNICIPALITY OF JUNIK

KOMUNA E JUNIKUT

**RAPORTI I BUXHETIT
KOMUNAL PËR
PERIUDHËN JANAR -
MARS/ 2025**

Junik, Prill -2025

Informata -I- Financiare Periodike 2025

Kërkesat për raportim

Informata Financiare Komunale për periudhën Janar – Mars 2025, bëhet në bazë të kërkesave për raportim të përkohshëm dhe vjetor bazuar në dispozitat e neneve 46.1 dhe 46.2 të Ligjit Nr. 03/L-048 “Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë” dhe statutit Komunal.

Informata Financiare Komunale Periodike ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë.

Ecuria e përgjithshme e këtyre treguesve do të prezantohet për 14 programet buxhetore :

1. Zyra e Kryetarit
2. Kuvendi Komunal
3. Administrata e Përgjithshme
4. Buxhet dhe Financa
5. Zhvillim Ekonomik
6. Shërbimet publike dhe Inspeksion
7. Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Mjedis
8. ZKK (Zyra Komunale për Komunitete)
9. Shëndetësi
10. Mirëqenie Sociale
11. Shërbimet e kujdesit primar
12. Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
13. Arsimi i mesëm
14. Arsimi fillor

TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PERIODIKE

